

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E ENJTE 10 MARS 2022

6 marsi korri atë që kishim mbjellë të gjithë ne, pozita dhe opozita, secili prej nesh mori frytet e veta të punës. Nga analiza që bëjmë nëse na pëlqejnë apo nuk na pëlqejnë këto fruta, kjo ka të bëjë vetëm me cilësinë e farës që mbollëm. Politika në Shqipëri është një fushë, ku mund t'i gjesh të mbjella të gjitha llojet e farave, farën e shpresës, të punës, të solidaritetit, të diturisë, të miqësisë, por edhe të përçarjes, të baltës, të urrejtjes, të thashethemet, të injorancës. Mbill një ide dhe do të korrësh një veprim, mbill një veprim dhe do të korrësh një sjellje, mbill një sjellje dhe do të korrësh një karakter, dhe, kur të kesh mbjellë një karakter, ajo që do të korrësh është fati i yt. Ky është ligji i karmës dhe kjo vlen edhe për sagën e komisionit hetimor të inceneratorëve. Çka u mboll, si u mboll dhe pse u mboll në komisionin "Big Brother incenerator" ishte pjesë e karakterit, që prodhoi fatin e secilës palë më 6 mars, ehe të opozitës, të grupuar veç e veç, sepse opozita nuk u nis në asnjë moment nga misioni, por nga intriga; nuk u nis nga dashuria, por nga urrejtja; nuk u nis nga fakti, por nga thashethemet.

Misioni i opozitës është të bëhet gardiani i mbrojtjes së interesave të shqiptarëve nga abuzimi i mundshëm i pushtetit. Motivimi i opozitës duhet të jetë dashuria për mirëqenien e popullit dhe jo urrejtja për kundërshtarin, kundërshtari politik konkurrohet, nuk urrehet. Përkundër këtyre parimeve, komisioni opozitar mori një thashethem, e ekzagjeroi me fantazi, e ushqeui me urrejtje, e ndriçoi me errësirë dhe pasi e mbolli në orë të gjata në dhomat e rrëfimit, u ul e priti me ngazëllim korrien e frytit më 6 mars. Rezultati: nuk mbiu asgjë gjë, fara u dogj që në ngjizje. A më gëzon mua kjo? Jo. Përkundrazi, më trishton dhe revolton njëkohësisht, sepse, në fakt, u dogj një instrument i demokracisë, u dogj një shpresë e shqiptarëve, por edhe imja, sepse opozita do të dinte të përdorte të paktën një herë të vetme instrumentet, me të cilat mund t'iu kallte datën të korruptuarve, të supozuar, në tentativë apo realë qofshin, dhe t'i bënte të mendoheshin dy herë para se të ngjyjnë gishtin e tyre të trashë mbi djersën e këtij populli. Opozita shqiptare nuk mund t'i bënte shpërdorim më të madh këtij instrumenti të demokracisë, komisionit hetimor parlamentar.

Nga një çështje serioze, që kishte ngjallur interesin e të gjithë opinionit publik, një çështje që mund të bëhej shembull i gjyqit popullor, që mund të bëhej shembull transparence dhe, mbi të gjitha, shembull i qartë profesionalizmi të ftohtë e korrekt, opozita e ktheu në një maratonë replikash protagonizmi bosh, retorikë që më shumë ngatërron, se sqaron. Në fund edhe këtë herë shqiptarët shkuan të flenë të zhgënjyer, të ngatërruar nëpër labirintet 1000-pyetëshe, të keqpërdorur. Ajo çka patëm nga opozita ishte vetëm një rrokopujë shifrash, që herë shkonin në stratosferë, herë zbrisnin me negociim poshtë, pastaj ngriheshin e uleshin përsëri, si një termometër i prishur, në fund publiku votoj për një notë ngelëse në datën 6 mars. Por, siç e thashë më lart, kjo, në fakt, është trishtuese. Unë prisja me interes të mësoja nëse vërtet paratë e taksapaguesve kanë përfunduar nëpër xhepa zyrtarësh, edhe sikur 1 lekë. Unë prisja me padurim të mësoja edhe nëse një biznesmen ka përfituar një normë më të madhe fitimi se sa i takonte të fitonte në një treg konkurrues, sikur qoftë edhe 1 lekë më shumë. Unë prisja të mësoja nëse një strukturë publike ka mbyllur njërin sy dhe ka lënë drejtin të kalojë. Sigurisht, nuk kam më

iluzion se këto përgjigje do t'i gjej tek raporti i këtij komisioni opozitar, sepse, ashtu siç të gjithë shqiptarët, edhe unë kuptova se nuk kishte qenë asnjë moment objektiv i tij i vërtetë, në fakt, konfuzioni dhe shantazhi ishin qëllimi i tij i vërtetë, madje tuktuk edhe gara për protagonizëm.

Unë do të pres me besim të madh se profesionistët e drejtësisë së reformuar do ta bëjnë këtë shërbim për popullin, që beson se çdo ditë e më shumë se kush e ka shkelur trupin e tij të drobitur do të marrë më në fund ndëshkimin, siç po merr ndëshkim opozita për shpërdorim misioni. Sa për ne socialistët, ne jemi të stërvitur për të nxjerrë mësim nga çdo debat, të dalim më të fortë nga çdo betejë dhe të përmirësohemi duke ecur përpara; sidomos ne jemi stërvitur të ndihemi më keq pas çdo fitoreje, më keq se pse nuk e kemi bërë Shqipërinë akoma më mirë, dhe kjo ndjenjë na ndihmon për të gjetur rrugë të tjera për të arritur këtë qëllim. Ne kemi dhe një motivim që vjen nga ju, të dashur kolegë opozitarë, pasi në vesh na tingëllon ende zëri i mekur i liderit tuaj në letra tek përsëriste së fundi refrenin: "Si është Partia Demokratike sot do të jetë Shqipëria nesër". Po kush mund ta mallkojë Shqipërinë më shumë se sa kaq, edhe pse, në fakt, shqiptarët nga ky njeri nuk i zë as mallkimi dhe as balta?! Shqipëria ka zgjedhur rrugën e saj pa kthim pas dhe ky është motivimi ynë i vërtetë.